



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
RÉGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 03 korrik 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1268_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, dhe paragrafeve 3 dhe 4, Nenin 25 dhe Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e nenit nenit 5 dhe nenit 33 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1 dhe nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085;
- Rregullës Nr. 15/2017 për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal;
- Vendimit të ZRRE-së V_916_2017 për Vendosjen e Obligimit të Shërbimit Publik për "KESCO" J.S.C; dhe
- Vlerësimin e gjendjes aktuale të furnizimit të konsumatorëve fundor që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal;

në seancën e mbajtur më 03 korrik 2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. Vazhdohet afati i përcaktuar me pikën VIII të dispozitivit të Vendimit V_916_2017 i dt. 27 prill 2017, deri me 31 mars 2021.
- II. Dispozitat tjera të dispozitivit të Vendimit V_916_2017 i dt. 27 prill 2017, mbeten në fuqi.
- III. Ky Vendim do të jetë pjesë përbërëse e Licencës për Furnizim me Energji Elektrike të lëshuar "KESCO"-s.

ARSYETIM

- o ZRRE qysh në dhjetor të vitit të kaluar ka filluar procesin e vlerësimin e konkurrencës në tregun e furnizimit me pakicë të energjisë elektrike të konsumatorëve fundor. Ky proces ka qenë planifikuar të përfundojë gjatë kuartalit të parë të këtij viti, por për shkak të rrethanave të njohur që lidhen me pandeminë, ky proces nuk ka përfunduar ende.
- o Si rezultat i rrethanave të cekura më lartë ZRRE nuk ka mundur ta finalizoj Vlerësimin e filluar e i cili është parakusht që një Furnizuesi me pakicë me energji elektrike ti ngarkojë Obligimin e Shërbimit Publik-Furnizues me Shërbim Universal, e i cili obligim i është ngarkuar KESCO-s me Vendimin e ZRRE V_916_2017 si i vetmi furnizues aktiv me pakicë të energjisë elektrike, i cili aktualisht furnizon 100% të konsumatorëve fundor.

- Lidhur me këto rrethana si dhe pengesa që kanë reflektuar në mos finalizimin e këtij Vlerësimit të konkurrencës të tregut me pakicë të energjisë elektrike, ZRRE me shkresën e datës 30.06.2020 ka njoftuar edhe Sekretarin e Komunitetit të Energjisë (SKE) në mënyrë që ky proces të bëhet në koordinim dhe pajtim me SKE. Të njejtën ditë ZRRE ka pranuar shkresën nga Drejtori i SKE me të cilën gjithashtu na sugjerojnë që kjo shtyerje mos të kalojë datën 30.03.2021 ashtu si është përcaktuar në pikën një të dispozitivit të këtij Vendimi.
- Nga tërë kjo që u tha më lartë dhe duke pasur parasysh edhe draft Vlerësimit të gjendjes aktuale të furnizimit të konsumatorëve fundor që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal, i cili konstaton se aktualisht vetëm njëri nga të licencuarit (KESCO) ushtron aktivitetin e tij në treg, dhe ka 100% të pjesëmarrjes në treg, ZRRE ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

IV. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Bordi i Rregullatorit:




Arsim Janova, u.d. kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Ruzhiti, anëtar

Vendimi i dërgohet:
KESCO-s
Aktivit të Rregullatorit